

Asociacioni i Komunave në Republikën e Kosovës në të cilat Komuniteti Serb i Kosovës është në Shumicë

Janar 2023

Publikuesi: Friedrich Ebert Stiftung Kosovo, Rr. Pashko
Vasa 23, 10000 Prishtina, Republika e Kosoves

Përgjegjës: René Schlee

Koordinatori i projektit: Egzon Osmanaj

Zyrtare projekti: Iva Babic

Hulumtues i lartë: Senad Šabović

Data: Janar 2023

Dizajni: Milky Way Creative

Printuar nga: Studio Forma

Pikëpamjet e paraqitura në këtë publikim nuk
paraqesin domosdoshmërisht qëndrimin e Fondacionit
Friedrich Ebert apo të Institutit European për Paqe.

Parathënie

Ne, Instituti Evropian për Paqe (EIP) dhe Zyra e Fondacionit Friedrich-Ebert (FES) në Prishtinë kemi kënaqësinë që të ju paraqesim rezultatin e punës sonë në draft-statutin e "Asociacionit të Komunave në Republikën e Kosovës në të cilat Komuniteti Serb i Kosovës është në Shumicë".

Gjatë pranisë së vet në Kosovë tash e 23 vite, Zyra e Fondacionit Friedrich-Ebert në Prishtinë ka dhënë kontributin e vet gjatë diskutimeve publike dhe politikëbërjes për shumë çështje të ndryshme politike, ekonomike dhe sociale. Në kuadër të programit tonë, ne e kemi për qëllim të forcojmë Kosovën si një partner për paqe dhe siguri në rajon dhe të mbështesim agjendën e saj të përkushtuar politike për integrim në BE.

Instituti Evropian për Paqe është një fondacion i bazuar në interes publik me seli në Bruksel, i themeluar specifikisht për plotësimin dhe forcimin e paqebërjes evropiane dhe mbështetjes së përpjekjeve për zgjidhjen e konflikteve evropiane. Instituti ka qenë aktiv në rajonin e Ballkanit Perëndimor që në fillim të vitit 2021, përmes një fokusi gjithëpërfshirës në përpjekjet për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe të rolit të tyre jetësor që e kanë për stabilitetin rajonal.

Ndaj këtij historiku, të dyja organizatat kanë filluar me një numër të punëtorive të përbashkëta në vitin 2022 për çështjet e pazgjidhura që kanë të bëjnë me normalizimin e raporteve midis Kosovës dhe Serbisë. Njëra prej çështjeve të dalluara – dhe sfiduese – është themelimi i "Asociacionit të komunave me popullatë shumicë serbe," i cili buron nga Marrëveshja e Parë e arritur në Bruksel, në vitin 2013 mbi parimet për udhëheqjen e normalizimit të raporteve.

Në vitin 2015, Gjykata Kushtetuese e Kosovës konstatoi se "parimet, siç janë elaboruar në "Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë-Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore", nuk janë tërësisht në përputhshmëri me frymën e Kushtetutës, duke kërkuar që vendimet lidhur me bashkësinë/asociacionin, statuti dhe akti ligjor shoqërues nga qeveria, të jenë në përputhje të plotë me Kushtetutën [...]". Mirëpo, Gjykata po ashtu konstatoi se Asociacioni/Bashkësia është pjesë e Sistemit juridik të Kosovës dhe se Asociacioni/Bashkësia duhet të themelohet siç është e përcaktuar në Marrëveshjen e Parë [të parimeve të cilat udhëheqin me normalizimin e

raporteve], dhe kishte dhënë një udhëzim të detajuar se si duhet adresuar çfarëdo shqetësimi kushtetues gjatë themelimit të një Asociacioni/Bashkësie.

Që prej atëherë, nuk ka pasur ndonjë përpjekje për të paraqitur një propozim për diskutim publik dhe shqyrtim të hollësishëm. Ky publikim synon të plotësojë këtë zbrazëti.

Publikimi i përmban objektivat në vazhdim:

- (1) Paraqitjen e një propozimi për një "Asociacion të Komunave në Republikën e Kosovës në të cilat Komuniteti Serb i Kosovës është në Shumicë" që është në pajtim me sistemin kushtetues dhe juridik në fuqi në Kosovë;
- (2) Adresimin dhe përfshirjen e pritjeve dhe shqetësimeve praktike të banorëve të komunave anëtare të supozuara; dhe
- (3) Lehtësimin e diskutimit publik për një temë të një rëndësie nacionale në bazë të draft-statutit.

Për arritjen e një rezultati më të mirë të mundshme për këtë propozim, ne e kemi kryer një hulumtim të plotë të gjithë spektrit të dokumenteve që i japin një kornizë kësaj çështje, pasuar me një numër të punëtorive me ekspertë të fushës tematike dhe përfaqësues nga shoqëria civile. Me përfundimin e draftit punues, ne kemi kryer një rishikim juridik gjithëpërfshirës për t'u siguruar që propozimi ynë është kushtetues.

Duke e pasur parasysh vëmendjen e publikut për punën tonë në këtë çështje, duam të theksojmë se FES-i dhe EIP-ja janë organizata të pavarura jo-qeveritare dhe se ne as nuk kemi qenë të "autorizuar", e as që na është kërkuar nga ndonjëri prej akterëve të caktuar që të hartojmë një propozim. Në një mjedis jashtëzakonisht të politizuar, ky publikim më shumë duhet të shihet si një pikë fillestare për një kontribut i cili është i bazuar në dëshmi. Puna e jonë është prirë vetëm nga motivimi për të kontribuar në iniciimin e një diskutimi publik thelbësor dhe ofrimit të rekomandimeve të formësuara përmes ekspertizës lokale dhe ndërkombëtare – siç kemi bërë edhe në të shkuarën për shumë çështje të ndryshme politike dhe socio-ekonomike.

Në këtë publikim, ju do të gjeni një draft të statutit për një "Asociacion të Komunave në Republikën e Kosovës në të cilat Komuniteti Serb i Kosovës është në Shumicë," si dhe një shkresë shpjeguese e cila e ofron kontekstin e këtij propozimi.



René Schlee

Përfaqësues Rezident në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut
Friedrich-Ebert Foundation

Shpresojmë që drafti do të jetë tërheqës, i vëmendshëm dhe të paraqes një kontribut konstruktiv për përpjekjet në vazhdim për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Susanne Gents

Menaxhere e Lartë e Programit për Fqinjësi Evropiane
European Institute of Peace

Statuti i Asociacionit të Komunave në Republikën e Kosovës në të cilat Komuniteti i Serbëve të Kosovës është në Shumicë

Në bazë të Ligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes së Parë të Parimeve që rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, komunat në vijim (LISTA E KOMUNAVE) e formojnë Asociacionin/Bashkësinë e komunave në të cilat komuniteti i serbëve të Kosovës është në shumicë.

I. Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1

1. Asociacioni/Bashkësia është subjekt juridik i themeluar në përputhje me Kushtetutën dhe Sistemin juridik të Republikës së Kosovës.
2. Statuti i Asociacionit/Bashkësisë është akti më i lartë juridik i Asociacionit/Bashkësisë.
3. Statuti miratohet në kuvendin themelues të Asociacionit/Bashkësisë i cili përbëhet nga anëtarët e votuar të kuvendeve komunale të komunave pjesëmarrëse në pajtim me Ligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes së Parë dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Statuti miratohet me anë të një akti ligjor të Qeverisë së Kosovës dhe do të ketë fuqinë e rregullores së Qeverisë sipas Sistemit juridik të Kosovës, pasi të jetë shqyrtuar nga ana e Gjykatës Kushtetuese.
4. Kuvendi i Asociacionit/Bashkësisë është organ përgjegjës për amendamentimin e Statutit. Amendamentimet e Statutit duhet të ndjekin procedurën e njëjtë si atë të miratimit.
5. Kuvendi i Asociacionit/Bashkësisë përbëhet nga dhjetë (10) komunat në vijim (LISTA E KOMUNAVE) dhe i përfaqëson interesat e tyre dhe të banorëve të tyre. Anëtarësimi në Asociacion/Bashkësi është vullnetar. Procedurat për anëtarësim shtesë, largim nga anëtarësimi dhe shpërbërje të Asociacionit/Bashkësisë përcaktohen me këtë Statut.

6. Asociacioni/Bashkësia nuk i ndërron, zëvendëzon, ose zvoglon të drejtat dhe interesat e komuniteteve në Republikën e Kosovës, të cilat garantohen me Kushtetutën e saj dhe të cilat sigurohen nga sistemi juridik.

Neni 2

1. Anëtarët e Asociacionit/Bashkësisë janë autoritete komunale të komunave pjesëmarrëse.
2. Emërtimet zyrtare të këtij subjekti juridik janë: "Asociacioni/Bashkësia e Komunave në Republikën e Kosovës në të cilat Komuniteti Serb i Kosovës është në Shumicë," "Bashkësia e komunave në Republikën e Kosovës në të cilat Komuniteti Serb është në Shumicë," dhe "Asociacioni i Komunave në Republikën e Kosovës në të cilat Komuniteti Serb i Kosovës është në Shumicë". Të tria emërtimet zyrtare i referohen subjektit juridik të themeluar me këtë Statut. Në këtë Statut, përcaktimi Asociacion/Bashkësi do të thotë të gjitha ose cili do prej emërtimeve zyrtare. Organet zyrtare të Kosovës ose përfaqësuesit e Asociacionit/Bashkësisë kanë të drejtë t'i referohen Asociacionit/Bashkësisë me cilën do prej tre emërtimeve zyrtare.
3. Aktivitetet e Asociacionit/Bashkësisë bazohen në parimet e pjesëmarrjes vullnetare të anëtarëve të tij, avancimin e demokracisë dhe qeverisjes lokale, si dhe respektimin e dispozitave të mbrojtjes dhe përfaqësimit të të drejtave dhe interesave të komuniteteve të përfshira në Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës.
4. Autoritetet komunale i bashkohen Asociacionit/Bashkësisë në bazë të vendimit të kuvendeve të komunave të tyre në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë vendimmarrjen e këtij organi komunal. Në procesin e anëtarësimit në Asociacion/Bashkësi, secili anëtar duhet të miratojë Statutin e vet. Anëtarët e Asociacionit/Bashkësisë janë të lirë të anëtarësohen në asociacionet tjera nacionale, rajonale dhe ndërkombëtare në pajtim me sistemin juridik dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

kombëtare në pajtim me sistemin juridik dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

5. Anëtarët e Asociacionit/Bashkësisë kanë të drejtë të ndërpresin anëtarësimin e tyre. Vendimin për largimin nga Asociacioni/Bashkësia e merr kuvendi komunal i komunës përkatëse në pajtim me dispozitat ligjore që rregullojnë vendimmarrjen e këtij organi komunal. Një komunë që është larguar nga Asociacioni/Bashkësia mund të vendosë për rianëtarësimin e saj përmes procedurave të përshkruara në pikën 4 më sipër.
6. Asociacioni/Bashkësia do të jetë i hapur për çdo komunë tjetër me kusht që anëtarët të jenë dakord. Vendimi për pranimin e anëtarit të ri të Asociacionit/Bashkësisë do të merret me shumicën e thjeshtë të votave të delegatëve të Kuvendit.
7. Asociacioni/Bashkësia mund të shpërbëhet vetëm me vendim të Kuvendit të tij të miratuar me shumicë prej 2/3 e votave të anëtarëve të tij. Në rast se vendimi për shpërbërje miratohet nga Kuvendi i Asociacionit/Bashkësisë, shpërbërja e Asociacionit/Bashkësisë bëhet nga Qeveria. Pasuria e Asociacionit/Bashkësisë shpërndahet sipas vendimeve të Kuvendit të Asociacionit/Bashkësisë.

Anëtarët e Asociacionit/Bashkësisë kanë përgjegjësi që:

- Të respektojnë Statutin dhe aktet e organeve të Asociacionit;
 - Të paguajnë rregullisht tarifën e anëtarësimin;
 - Të mos veprojnë brenda ose përmes Asociacionit/Bashkësisë në kundërshtim me Statutin;
 - Të ruajnë integritetin, besueshmërinë dhe reputacionin e Asociacionit/Bashkësisë.
8. Anëtarët e Asociacionit/Bashkësisë kanë të drejtë të përjashtojnë një ose më shumë komuna nga anëtarësia me vendim të Kuvendit të tij të miratuar me shumicë prej 2/3 e votave nga anëtarët e tij.
 9. Asociacioni/Bashkësia do të ketë simbolet e veta zyrtare, të cilat do të përfshijnë një stemë dhe një flamur, i cili do të dizajnohet nga Bordi i Asociacionit/Bashkësisë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale.
 10. Selia e Asociacionit/Bashkësisë do të përcaktohet nga Statuti [gjatë finalizimit të tij dhe përmes konsultimit midis Asociacionit/hisedarëve të komunitetit].
 11. Asociacioni/Bashkësia ka të drejtë të ketë buxhetin e integruar, llogaritë bankare, dhe ka të drejtë që të jetë pronar i pasurisë dhe të angazhohet në transaksione financiare.

II. Objektivat e Asociacionit/Bashkësisë

Neni 3

1. Në përputhje me Marrëveshjen e Parë të Ratifikuar dhe Kushtetutën, Asociacioni/Bashkësia do të ketë si objektivi kryesor kryerjen e funksioneve dhe shërbimeve publike për:
 - a. Forcimin e demokracisë lokale. Asociacioni/Bashkësia e ushtron këtë funksion përmes lehtësimit të bashkëpunimit midis komunave pjesëmarrëse, mbështetjes së komunave pjesëmarrëse në hartimin e politikave që avancojnë demokracinë vendore, lehtësimin, financimin ose promovimin e aktiviteteve që avancojnë pjesëmarrjen qytetare dhe praktikatat demokratike, si dhe përfaqësimin e interesave të rëndësishme të demokracisë lokale tek autoritetet qendrore.
 - b. Promovimin dhe mbrojtjen e identiteteve etnike, gjuhësore, fetare dhe formave të tjera të identitetit kulturor të përfaqësuar në mesin e popullsisë së komunave të saj pjesëmarrëse. Në kryerjen e këtij funksioni, Asociacioni/Bashkësia do të lehtësojë bashkëpunimin midis komunave të saj pjesëmarrëse dhe do t'i mbështesë ato në hartimin e projekteve, politikave dhe masave që mbështesin, promovojnë dhe mbrojnë shprehjen kulturore dhe identitetin e përfaqësuar midis banorëve të tyre. Kjo mund të përfshijë lehtësimin dhe/ose financimin e projekteve në lidhje me kulturën dhe trashëgiminë kulturore në territorin e komunave pjesëmarrëse, si dhe në lidhje me mirëmbajtjen, rehabilitimin ose ndërtimin e vendeve të trashëgimisë kulturore. Asociacioni/Bashkësia gjithashtu mund të financojë ose organizojë ngjarje, fushata dhe forma të tjera të manifestimeve publike në lidhje me promovimin e kulturave dhe diversitetit kulturor të përfaqësuar në komunat pjesëmarrëse. Asociacioni/Bashkësia mund të ofrojë këshilla teknike, ligjore dhe profesionale për komunat e veta pjesëmarrëse dhe autoritetet qendrore në lidhje me legjislacionin, politikën, aktivitetet dhe angazhimin publik në sferën e kulturës dhe diversitetit kulturor. Në kryerjen e këtyre funksioneve, Asociacioni/Bashkësia do të respektojë diversitetin kulturor të përfaqësuar në mesin e banorëve të komunave pjesëmarrëse dhe normat e diversitetit të përfshira në Kushtetutën dhe Sistemin juridik të Republikës së Kosovës.
 - c. Të bëjë një pasqyrë të plotë për të zhvilluar ekonominë lokale. Asociacioni/Bashkësia e ushtron këtë funksion përmes lehtësimit të bashkëpunimit midis komunave pjesëmarrëse, duke i mbështetur ato në

- hartimin e projekteve, politikave dhe masave që zhvillojnë ekonomitë e tyre lokale ose duke ndihmuar në angazhimin e burimeve financiare dhe njerëzore relevante për shërbimet ekonomike, financimin dhe promovimin e aktiviteteve që rrisin zhvillimin ekonomik, investimet dhe lidhjen e biznesit, dhe duke përfaqësuar interesat e komunave pjesëmarrëse dhe aktorëve ekonomikë që gjenden në territoret e tyre në marrëdhënie me autoritetet qendrore, si dhe me operatorët e tjerë shtetërorë dhe ekonomikë në rajon dhe më gjerë, përfshirë ata nga Republika e Serbisë. Për kryerjen e këtyre funksioneve, Asociacioni/Bashkësia rregullisht pranon dokumentet e prodhuara nga autoritetet ekonomike, financiare dhe buxhetore të komunave pjesëmarrëse dhe ka të drejtë të kërkojë informacion shtesë nga komunat pjesëmarrëse, sipas nevojës për kryerjen e këtij funksioni. Asociacioni/Bashkësia gjithashtu ka të drejtë të kërkojë informacion zyrtar nga autoritetet qendrore përkatëse për kryerjen e këtyre funksioneve.
- d. Të bëj një pasqyrë të plotë në fushën e arsimit. Asociacioni/Bashkësia përmbush këtë objektiv nëpërmjet kryerjes së funksioneve të mëposhtme:
- Lehtësimi i bashkëpunimit midis anëtarëve të vet me qëllim të avancimit të standardeve të arsimit në nivel lokal.
 - Përfaqësimi i interesave të politikës arsimore të anëtarëve të vet dhe banorëve të tyre me autoritetet qendrore.
 - Kryerja e hulumtimeve dhe ndjekja e trendeve të arsimit në mesin e anëtarëve të vet, në Kosovë dhe jashtë saj, dhe ofrimi i udhëzimeve për avancimin e standardeve të arsimit, politikave dhe aftësive teknike.
 - Sigurimi i mbështetjes ligjore, shkencore, financiare dhe sekretariale për anëtarët e vet në zbatimin e kompetencave të tyre në fushën e arsimit, përfshirë arsimin e lartë, siç parashikohet me ligj.
 - Sigurimi i një roli këshillues për autoritetet qendrore dhe autoritetet e komunave të veta pjesëmarrëse në lidhje me zhvillimin dhe sigurimin e arsimit sipas kurrikulës serbe, siç rregullohet me ligjin e Kosovës.
 - Ofrimi i këshillave ligjore, lëndore dhe të bazuara në hulumtime për autoritetet qendrore dhe komunat pjesëmarrëse në lidhje me përcaktimin e numrit të mësimdhënësve, menaxhmentit të shkollave dhe stafit mbështetës dhe nivelit të pagave për sistemin arsimor në komunat pjesëmarrëse.
 - Ofron këshilla ligjore, lëndore dhe të bazuara në hulumtime për autoritetet qendrore në lidhje me menaxhimin e sektorit të arsimit në territorin e komunave pjesëmarrëse.
 - Financimi i iniciativave të lidhura me arsimin – duke përfshirë bursat, trajnimin e mësimdhënësve,
- grantet kërkimore, zgjidhjet e TI-së, shkëmbimet akademike, programet verore dhe të tjera për të mirën e avancimit të arsimit midis komunave pjesëmarrëse.
- Financimi i projekteve të ndërtimit dhe infrastrukturës në lidhje me ofrimin e arsimit midis komunave pjesëmarrëse, si dhe ofrimi i mbështetjes financiare për mirëmbajtjen e objekteve arsimore dhe atyre përkatëse (salla sportive, laboratorë TI, etj).
- Lehtësimi dhe/ose financimi i transportit dhe shpërndarjes së teksteve shkollore arsimore në lidhje me arsimin sipas kurrikulës serbe sipas ligjit të Kosovës. Asociacioni/Bashkësia do të ofrojë të njëjtin shërbim për arsimin me kurrikulë të Kosovës në gjuhën shqipe dhe gjuhë të tjera nëse është e nevojshme për ndonjë grup të banorëve të komunave pjesëmarrëse.
- Ndërlidhja me palët e tjera, duke përfshirë autoritetet arsimore të Republikës së Serbisë, për përmbushjen e këtij objekti.
- Ofrimi i këshillave për autoritetet qendrore për ndryshimet që lidhen me legjislacionin për arsimin.
2. Për kryerjen e funksioneve të përcaktuara më sipër, Asociacioni/Bashkësia do të marrë rregullisht dokumente të prodhuara nga autoritetet arsimore të komunave pjesëmarrëse dhe do të ketë të drejtë të kërkojë informacion shtesë nga komunat pjesëmarrëse me rendësi për kryerjen e këtij funksioni. Asociacioni/Bashkësia gjithashtu ka të drejtë të kërkojë informacion zyrtar nga autoritetet qendrore përkatëse për kryerjen e këtyre funksioneve.
3. Gjatë kryerjes së pasqyrës së plotë në fushën e arsimit, Asociacioni/Bashkësia do t'i përmbahet plotësisht Kushtetutës dhe Sistemit ligjor të Republikës së Kosovës. Rishikimi administrativ i akteve të komunave nga autoritetet qendrore në fushën e kompetencave të tyre, i kufizuar në sigurimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin, siç është theksuar në Nenin 124.7 të Kushtetutës, do të zbatohet *mutatis mutandis* në lidhje me vendimet e Asociacionit/Bashkësisë.
- e. Të bëhet një pasqyrë e plotë për të përmirësuar kujdesin shëndetësor parësor dhe dytësor dhe kujdesin social lokal. Asociacioni/Bashkësia e përmbush këtë objektiv nëpërmjet kryerjes së funksioneve të mëposhtme:
- Lehtësimi i bashkëpunimit midis anëtarëve të vet me qëllim të avancimit të kujdesit shëndetësor parësor dhe dytësor dhe mirëqenies sociale në nivel lokal.
 - Përfaqësimi i interesave të politikës shëndetësore të anëtarëve të vet dhe banorëve të tyre me autoritetet qendrore.

- Kryerja e hulumtimeve dhe ndjekja e trendeve të shëndetit dhe mirëqenies sociale në mesin e anëtarëve të vet, në Kosovë dhe jashtë saj, si dhe ofrimi i udhëzimeve për avancimin e dispozitave shëndetësore dhe të mirëqenies sociale, politikave dhe hulumtimeve.
 - Sigurimi i mbështetjes ligjore, shkencore, financiare dhe sekretariale për anëtarët e saj në zbatimin e kompetencave të tyre në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, siç parashikohet në ligj.
 - Ofron këshilla ligjore, lëndore dhe të bazuara në hulumtime për autoritetet qendrore në lidhje me menaxhimin e sektorit të shëndetësisë në territorin e komunave pjesëmarrëse.
 - Sigurimi i një roli këshillues për autoritetet qendrore dhe ato të komunave pjesëmarrëse në lidhje me çdo nevojë specifike shëndetësore dhe të mirëqenies sociale të banorëve të tyre.
 - Ofrimi i këshillave ligjore, lëndore dhe të bazuara në hulumtime për autoritetet qendrore dhe komunat pjesëmarrëse në lidhje me përcaktimin e numrit të profesionistëve shëndetësorë, menaxhmentit dhe stafit mbështetës dhe nivelit të pagave në komunat pjesëmarrëse.
 - Financimi dhe lehtësimi i ngritjes së kapaciteteve dhe aftësisë profesionale të personelit mjekësor dhe të mirëqenies sociale të komunave pjesëmarrëse, në dobi të përmirësimit të kujdesit shëndetësor dhe social midis komunave pjesëmarrëse.
 - Financimi i projekteve të ndërtimit dhe infrastrukturës në lidhje me ofrimin e kujdesit shëndetësor dhe mirëqenies sociale midis komunave pjesëmarrëse. Asociacioni/Bashkësia gjithashtu siguron mbështetje financiare për mirëmbajtjen e objekteve mjekësore.
 - Financimi i strehimit social në komunat pjesëmarrëse, respektimi i diversitetit etnik të popullsisë së vet dhe dispozitat e ligjit të Kosovës në lidhje me përzgjedhjen e përfutjesve.
 - Financimi i objekteve, pajisjeve dhe shpenzimeve materiale në lidhje me çdo nevojë specifike shëndetësore ose të mirëqenies sociale në komunat pjesëmarrëse, siç janë ato që lidhen me ofrimin e kujdesit shëndetësor mobil, personat me aftësi të kufizuara ose kujdesin shëndetësor për personat e moshuar.
 - Financimi dhe/ose ngritja e fondeve për mbështetjen e mirëqenies sociale të banorëve të komunave pjesëmarrëse, duke respektuar diversitetin e tyre etnik.
 - Promovimi, lehtësimi dhe financimi i fushatave të ndërgjegjësimit për shëndetin publik dhe masave për përmirësimin e standardeve të shëndetit publik, përveç atyre që sigurohen rregullisht nga kujdesi shëndetësor, sipas ligjeve përkatëse.
 - Në kohë të pandemive ose krizave të shëndetit publik, Asociacioni/Bashkësia mbështet zbatimin e masave të shëndetit publik të siguruar nga Qeveria për komunat pjesëmarrëse.
 - Në kohë të pandemive ose kur është e nevojshme, financon dhe/ose lehtëson sigurimin e ilaçeve, vaksinave dhe pajisjeve mjekësore për nevojat e banorëve të komunave pjesëmarrëse.
 - Ndërlidhja me palët e tjera, duke përfshirë autoritetet shëndetësore të Republikës së Serbisë, për përmbytjen e këtij objekti.
 - Financimi i blerjes së pajisjeve mjekësore të specializuara që mund të nevojiten nga komuna pjesëmarrëse dhe vendosja e pajisjeve të blera nën menaxhimin e institucioneve mjekësore të parashikuara me ligj.
 - Këshillimi i autoriteteve qendrore në drejtim të kujdesit shëndetësor parësor dhe dytësor dhe kujdesit social në komunat pjesëmarrëse, si dhe në drejtim të ndryshimeve në legjislacionin për kujdesin shëndetësor komunal parësor dhe dytësor dhe kujdesin social.
 - Përmes një komisioni të përbashkët të themeluar me autoritetet qendrore, duke lehtësuar pagesën e asistencës financiare të mirëqenies sociale nga Republika e Serbisë për përfutjesit që banojnë në komunat pjesëmarrëse.
4. Për kryerjen e funksioneve të përcaktuara më sipër, Asociacioni/Bashkësia do të marrë rregullisht dokumente të prodhuara nga autoritetet shëndetësore të komunave pjesëmarrëse dhe do të ketë të drejtë të kërkojë informacion shtesë nga komunat pjesëmarrëse me rëndësi për kryerjen e këtij funksioni. Asociacioni/Bashkësia gjithashtu ka të drejtë të kërkojë informacion zyrtar nga autoritetet qendrore përkatëse për kryerjen e këtyre funksioneve.
5. Gjatë kryerjes së pasqyrës së plotë në fushën e kujdesit shëndetësor parësor dhe dytësor, Asociacioni/Bashkësia do t'i përmbahet plotësisht Kushtetutës dhe Sistemit juridik të Republikës së Kosovës. Rishikimi administrativ i akteve të komunave nga autoritetet qendrore në fushën e kompetencave të tyre, i kufizuar në sigurimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjin, siç është theksuar në Nenin 124.7 të Kushtetutës, do të zbatohet *mutatis mutandis* në lidhje me vendimet e Asociacionit/Bashkësisë.
- f. Një pasqyrë e plotë për të koordinuar planifikimin urban dhe rural. Asociacioni/Bashkësia e përmbyt këtë objektiv nëpërmjet kryerjes së funksioneve të mëposhtme:
- Lehtësimi i bashkëpunimit midis anëtarëve të vet me qëllim të planifikimit urban dhe rural ndër-komunal.

- Përfaqësimi i interesave të komunave pjesëmarrëse te autoritetet qendrore në lidhje me planifikimin urban dhe rural ndër-komunal.
 - Kryerja e hulumtimeve dhe formave të tjera të mbështetjes teknike për komunat pjesëmarrëse në zbatimin e kompetencave të tyre ligjore në planifikimin urban dhe rural.
 - Sigurimi i mbështetjes ligjore, shkencore, financiare dhe sekretariale për anëtarët e saj në zbatimin e kompetencave të tyre në fushën e kompetencave të tyre ligjore në planifikimin urban dhe rural.
 - Financimi dhe/ose lehtësimi i programeve të ngritjes së kapaciteteve në fushën e planifikimit urban dhe rural.
 - Ofrimi i këshillave për autoritetet qendrore në lidhje me projektet e infrastrukturës ndër-komunale në lidhje me komunat pjesëmarrëse.
 - Sigurimi i udhëzimeve për komunat pjesëmarrëse në lidhje me kompetencat e tyre ligjore për zhvillimin urban dhe hartat e zonimit.
 - Ofrimi i udhëzimeve dhe mbështetjes për komunat pjesëmarrëse për mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.
 - Ofrimi i këshillave për autoritetet qendrore mbi ndryshimet në legjislacionin në lidhje me planifikimin urban dhe rural komunal.
 - Ofrimi i këshillave ligjore, lëndore dhe të bazuara në hulumtime për autoritetet qendrore dhe komunat pjesëmarrëse në lidhje me proceset e shpronësimit në territoret e komunave pjesëmarrëse.
6. Për kryerjen e funksioneve të përcaktuara më sipër, Asociacioni/Bashkësia do të marrë rregullisht dokumente të prodhuara nga autoritetet për planifikim urban dhe rural të komunave pjesëmarrëse dhe do të ketë të drejtë të kërkojë informacion shtesë nga komunat pjesëmarrëse me rëndësi për kryerjen e këtij funksioni. Asociacioni/Bashkësia gjithashtu ka të drejtë të kërkojë informacion zyrtar nga autoritetet qendrore përkatëse për kryerjen e këtyre funksioneve.
7. Gjatë kryerjes së pasqyrës së plotë në fushën e planifikimit urban dhe rural, Asociacioni/Bashkësia do t'i përmbahet plotësisht Kushtetutës dhe Sistemit juridik të Republikës së Kosovës. Rishikimi administrativ i akteve të komunave nga autoritetet qendrore në fushën e kompetencave të tyre, i kufizuar në sigurimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjin, siç është theksuar në Nenin 124.7 të Kushtetutës, do të zbatohet *mutatis mutandis* në lidhje me vendimet e Asociacionit/Bashkësisë.
- g. Miratimi i masave për përmirësimin e kushteve lokale të jetesës për të kthyerit në Kosovë. Asociacioni/Bashkësia e përmbush këtë objektiv nëpërmjet kryerjes së funksioneve të mëposhtme:
- Lehtësimi i bashkëpunimit midis komunave pjesëmarrëse për të mirën e komunitetit të të kthyerve.
 - Financimi i zgjidhjeve të strehimit për të kthyerit në Kosovë në komunat pjesëmarrëse.
 - Ndërlidhja me komunitetin e të zhvendosurve dhe identifikimi i nevojave të veçanta për t'u adresuar në kontekstin e kthimit dhe zgjidhjeve dhe këshillave të tjera të qëndrueshme për komunat pjesëmarrëse në drejtim të përmbushjes së këtyre nevojave brenda kompetencave të tyre ligjore.
 - Ndërlidhja dhe bashkëpunimi me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim dhe institucionet tjera qendrore në lidhje me zbatimin e strategjive përkatëse dhe dokumenteve rregullatore për kthimin, sipas rëndësisë për zbatimin nga komunat pjesëmarrëse.
 - Ofrimi i këshillave dhe udhëzimeve për komunat pjesëmarrëse në aspektin e politikave dhe masave për integrimin socio-ekonomik të të kthyerve.
 - Financimi i programeve të integritit socio-ekonomik për të kthyerit në komunat pjesëmarrëse. Asociacioni/Bashkësia gjithashtu ofron forma të tjera të ndihmës financiare dhe materiale për të kthyerit, duke përfshirë edhe jashtë komunave pjesëmarrëse.
 - Ofrimi i këshillave për komunat jo-pjesëmarrëse relevante për politikën dhe masat e tyre lidhur me kthimin.
 - Ofrimi i këshillave për autoritetet qendrore në lidhje me legjislacionin, politikën, strategjitë dhe masat në mbështetje të kthimeve.
 - Lehtësimi i kthimit dhe ofrimi i formave të tjera të zgjidhjeve të qëndrueshme në lidhje me kthimin e personave të zhvendosur në komunat pjesëmarrëse nga zonat e tjera të Kosovës.
8. Për kryerjen e funksioneve të përcaktuara më sipër, Asociacioni/Bashkësia do të marrë rregullisht dokumente të prodhuara nga autoritetet përkatëse për kthim nga komunat pjesëmarrëse dhe do të ketë të drejtë të kërkojë informacion shtesë nga komunat pjesëmarrëse me rëndësi për kryerjen e këtij funksioni. Asociacioni/Bashkësia gjithashtu ka të drejtë të kërkojë informacion zyrtar nga autoritetet qendrore përkatëse për kryerjen e këtyre funksioneve.
9. Në përmbushje të këtij objekti, Asociacioni/Bashkësia do t'i përmbahet plotësisht Kushtetutës dhe Sistemit juridik të Republikës së Kosovës. Rishikimi administrativ i akteve të komunave nga autoritetet qendrore në fushën e kompetencave të tyre, i kufizuar në sigurimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjin, siç është theksuar në nenin 124.7 të Kushtetutës, do të zbatohet *mutatis mutandis* në lidhje me vendimet e Asociacionit/Bashkësisë.

- h. Kryerja, kordinimi dhe lehtësimi i aktiviteteve kërkimore dhe zhvillimore. Në përmbushjen e këtij objekti dhe përveç aktiviteteve kërkimore dhe zhvillimore të përshkruara më sipër, Asociacioni/Bashkësia do të kryejë çdo aktivitet tjetër kërkimor dhe zhvillimor që konsiderohet i nevojshëm nga komunat pjesëmarrëse, me rëndësi për nevojat e tyre individuale ose ato që lidhen me bashkëpunimin ndërkomunal.
- i. Të promovojë, shpërndajë dhe mbrojë çështjet me interes të përbashkët të anëtarëve të vet dhe t'i përfaqësojë ato, duke përfshirë edhe pranë autoriteteve qendrore. Në përmbushjen e këtij objekti dhe krahas veprimtarive të përshkruara në objektivat e mësipërme, Asociacioni/Bashkësia do të promovojë dhe mbrojë çështjet me interes të përbashkët të anëtarëve të vet dhe do t'i përfaqësojë ata pranë autoriteteve qendrore siç kërkohet nga anëtarët. Në përmbushjen e këtij funksioni, Asociacioni/Bashkësia nuk do të dëmtojë apo anashkalojë kompetencat komunale të parashikuara me Kushtetutë dhe ligj dhe kanalet e komunikimit, raportimit dhe bashkëpunimit ndërmjet komunave dhe autoriteteve qendrore ose ndërmjet banorëve dhe autoriteteve qendrore.
- j. Ofron shërbime për anëtarët e vet në përputhje me ligjin e Kosovës. Në përmbushje të këtij objekti dhe krahas shërbimeve të përshkruara më lartë, Asociacioni/Bashkësia do të ofrojë shërbime të tjera që mund të kërkohen nga anëtarët e vet ose asociacionet e komuniteteve lokale të komunave pjesëmarrëse, në përputhje me ligjet e Sistemit juridik të Kosovës dhe pa i dëmtuar ose anashkaluar kompetencat komunale dhe komunikimin e siguruar me Kushtetutë dhe ligj, raportimin dhe kanalet e bashkëpunimit ndërmjet komunave dhe autoriteteve qendrore ose ndërmjet banorëve dhe autoriteteve qendrore.
- k. Vlerëson ofrimin e shërbimeve publike për anëtarët e vet dhe banorët e tyre për të mbështetur Asociacionin/Bashkësinë në formimin e qëndrimeve me interes të përbashkët për pjesëmarrjen në punën e autoriteteve qendrore. Për kryerjen e këtij funksioni, Asociacioni/Bashkësia ka të drejtë të kërkojë informacion zyrtar nga komunat dhe autoritetet qendrore relevante për vlerësimin e ofrimit të shërbimeve publike. Këto vlerësime do të përdoren për udhëzim për autoritetet komunale dhe institucionet qendrore në lidhje me përmirësimet në ofrimin e shërbimeve publike, si dhe për formulimin e qëndrimeve të interesave të përbashkëta të anëtarëve të vet ose banorëve të tyre për pjesëmarrje në punën e autoriteteve qendrore, në lidhje me çështjet që lidhen me shërbimet publike.
1. Kryerja e monitorimit siç kërkohet për zbatimin e objektivave të tij. Në përmbushje të objektit të tij
- h. të monitorimit, Asociacioni/Bashkësia ka të drejtë të kërkojë informacion zyrtar nga anëtarët e vet në të gjitha fushat e mbuluara nga objektivat e tij të listuara më sipër.
- m. Vendosja e marrëdhënieve dhe lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me asociacionet e tjera të komunave, vendore, rajonale dhe ndërkombëtare, me rëndësi për përmbushjen e objektivave të veta dhe në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet përkatëse të Kosovës.
- n. Siguron tema dhe këshilla ligjore për komunat e veta pjesëmarrëse dhe autoritetet qendrore në lidhje me çështjet e pazgjidhura në kryerjen e ndërhyrjeve legjislative, buxhetore, administrative ose të politikave që kanë të bëjnë me zbatimin e marrëveshjeve të normalizimit të marrëdhënieve. Me kërkesë të qartë të Qeverisë së Kosovës ose të ndonjë autoriteti tjetër qendror të mandatuar, Asociacioni/Bashkësia, në pajtim me qeverisjen e vet të brendshme demokratike, mund të formojë komisione të posaçme, vetë ose së bashku me autoritetet qendrore, për lehtësimin e zgjidhjeve administrative të kërkuara për këtë zbatim, siç është verifikimi i diplomave dhe certifikatave. Ky nen mund të zbatohet edhe për çështje të hapura ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, siç është pranimi i ndërsjellë i certifikatave fitosanitare dhe çështje të ngjashme me rëndësi për lëvizjen e lirë të njerëzve dhe për tregtinë.

Neni 4

1. Në përmbushjen e objektivave të veta, Asociacioni/Bashkësia nuk do të dëmtojë apo anashkalojë autoritetin dhe kompetencat e parashikuara me Kushtetutë dhe ligj të komunave pjesëmarrëse dhe as në asnjë mënyrë nuk do të zëvendësojë apo minojë marrëdhëniet e parashikuara me Kushtetutë dhe ligj midis autoriteteve qendrore dhe lokale në Republikën e Kosovës.

Neni 5

1. Asociacioni/Bashkësia do të ushtrojë kompetenca të tjera shtesë siç mund të delegohen nga autoritetet qendrore në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës.

III. Struktura organizative

Neni 6

1. Asociacioni/Bashkësia do të ketë këto organe:
- Kuvendi i Asociacionit/Bashkësisë;
 - Kryetari i Asociacionit/Bashkësisë;

- Zëvendëskryetari i Asociacionit/Bashkësisë;
 - Këshilli i Asociacionit/Bashkësisë;
 - Bordi i Asociacionit/Bashkësisë;
 - Zyra për Ankesa dhe Parashtrësia e Asociacionit/Bashkësisë.
2. Organet e Asociacionit/Bashkësisë do të promovojnë bashkëjetesën dhe paqen midis qytetarëve të komunave të tyre anëtare dhe do të inkurajojnë ndërtimin e kushteve të përshtatshme për t'iu mundësuar të gjitha komuniteteve të shprehin, ruajnë dhe zhvillojnë identitetin e tyre kombëtar, etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor.

Neni 7

1. Kuvendi i Asociacionit/Bashkësisë është organi më i lartë i tij, i përbërë nga përfaqësues të emëruar nga secili kuvend i komunave pjesëmarrëse në mesin e anëtarëve të tyre të zgjedhur, dhe do të pasqyrojë përbërjen e kuvendeve të komunave.
2. Numri i përfaqësuesve të Kuvendit përcaktohet nga numri i përfaqësuesve në kuvendet e komunave pjesëmarrëse në raport 10 me 1. Secila komunë pjesëmarrëse e delegon nga një përfaqësues në Kuvendin e Asociacionit/Bashkësisë për secilën nga dhjetë vendet e asamblesë komunale.
3. Delegatët për Kuvendin e Asociacionit/Bashkësisë zgjidhen nga kuvendi komunal përkatës me propozim të kryetarit të komunës.
4. Gjatë propozimit dhe përzgjedhjes, kryetari i komunës dhe kuvendet komunale do të respektojnë parimin e sigurimit të diversitetit etnik të komunës së tyre. Në këtë mënyrë, proporcionet etnike të përfaqësuara në kuvendin komunal do të reflektohen në përbërjen e delegatëve të tij në Kuvendin e Asociacionit/Bashkësisë. Në këtë proces, kryetarët e komunave dhe kuvendet komunale do të respektojnë normat e të drejtave të komuniteteve të përfshira në Kushtetutën dhe Sistemin juridik të Republikës së Kosovës.
5. Mandati i Kuvendit do të jetë i lidhur me mandatet e kuvendeve komunale të komunave pjesëmarrëse. Në çdo zgjedhje lokale, brenda një muaji pas themelimit të kuvendeve komunale, kuvendet komunale të themeluara në këtë mënyrë do t'iu nënshtrohen procedurës së zgjedhjes së përfaqësuesve të tyre për Kuvendin e Asociacionit/Bashkësisë, sipas procedurave të përshkruara më sipër dhe në përputhje me ligjin.
6. Mandati i delegatëve të Kuvendit përfundon me mbarimin e mandatit të tyre në kuvendin komunal përkatës. Të gjitha format e parapara me ligj për përfundimin e mandatit si këshilltar i kuvendit komunal

do të zbatohen deri në fund të mandatit në Kuvendin e Asociacionit/Bashkësisë. Në rast të përsëritjes së zgjedhjeve ose zgjedhjeve të përsëritura në një komunë të caktuar pjesëmarrëse, mandati i përfaqësuesve të asaj komune në Asociacion/Bashkësi përfundon dhe zëvendësohet nga delegatët e kuvendit komunal të themeluar përmes zgjedhjeve të përsëritura ose të përsëritura sipas procedurave të përshkruara më sipër dhe në përputhje me ligjin.

7. Kuvendi komunal i secilës komunë pjesëmarrëse ka të drejtë ta revokojë mandatin e një ose më shumë delegatëve të vet në Kuvendin e Asociacionit/Bashkësisë. Revokimi i mandatit duhet të arsyetohet në kuptim të respektimit të këtij Statuti dhe të Sistemit juridik të Kosovës. Në zëvendësimin e delegatëve të vet në Kuvend, kuvendet komunale do të respektojnë parimin e diversitetit etnik të përshkruar më sipër. Iniciativën për zëvendësimin e delegatit në Kuvend mund ta marrin kryetari i komunës, zëvendëskryetari i komunës për komunitete, zëvendëskryetari i kuvendit të komunës për komunitete ose ndonjë këshilltar i kuvendit të komunës. Vendimet për revokimin e mandatit dhe zëvendësimin e tij merren nga kuvendi komunal i komunës përkatëse.
8. Delegatët në Kuvendin e Asociacionit/Bashkësisë do të kenë të drejtë në kompensim financiar për punën e tyre në Kuvend. Kompensimi financiar do të përcaktohet nga Rregullorja e Punës e Kuvendit dhe do të jetë në përputhje me standardet financiare të shërbimit publik të rregulluara me ligjin e Kosovës.

Neni 8

1. Mbledhjet e Kuvendit të Asociacionit/Bashkësisë thirren dhe udhëhiqen nga Kryetari i Asociacionit/Bashkësisë. Në mungesë të tij/saj, mbledhjet do të thirren dhe kryesohen nga Nënkryetari i Asociacionit/Bashkësisë. Në rast se të dy mungojnë ose pengohen, delegati më i vjetër në dispozicion mund të thërrasë dhe të kryesojë mbledhjen përkatëse të Kuvendit.
2. Mbledhjet e Kuvendit thirren me iniciativën e Kryetarit të Asociacionit/Bashkësisë, Kryesisë së Asociacionit/Bashkësisë, ose nga 1/3 e delegatëve të Kuvendit të Asociacionit/Bashkësisë.
3. Pas inaugurimit dhe brenda tre muajve, Kuvendi do të hartojë Rregulloren e punës për qeverisjen e sistemit të vet të votimit dhe çështjeve të tjera procedurale. Rregullorja e punës do të jetë në përputhje me Statutin dhe Sistemin juridik të Kosovës. Rregullorja e punës, sa më ngusht që të jetë e mundur, do të pasqyrojë rregullat e procedurës së kuvendeve komunale në Kosovë. Rregullorja e punës kërkon miratimin e 2/3 të delegatëve të Kuvendit.

4. Kuvendi mbledhet të paktën dy herë në vit dhe mund të mbajë takime të tjera të rregullta dhe takime ad hoc. Çaktimi dhe procedurat e tjera të mbledhjeve të Kuvendit do të rregullohen me Rregulloren e Punës.

Neni 9

1. Kuvendi miraton Statutin e Asociacionit/Bashkësisë, në përputhje me dispozitat e përshkruara më sipër.
2. Kuvendi shqyrton dhe miraton ndryshime në Statutin e Asociacionit/Bashkësisë, në pajtim me dispozitat e përshkruara më sipër.
3. Kuvendi miraton Rregulloren e punës, në përputhje me dispozitat e përshkruara më sipër.
4. Kuvendi vendos për pranimin dhe shkarkimin e delegatëve të tij, në përputhje me dispozitat e përshkruara më sipër.
5. Kuvendi zgjedh dhe shkarkon Kryetarin, Nënkryetarin dhe Bordin e Asociacionit/Bashkësisë.
6. Kuvendi shqyrton dhe miraton buxhetin e Asociacionit/Bashkësisë.
7. Me rekomandim të Kryetarit ose të Bordit të Asociacionit/Bashkësisë, Kuvendi shqyrton dhe miraton dokumentet udhëzuese strategjike për politika që janë me rëndësi për punën e Asociacionit/Bashkësisë ose për zbatimin e objektivave të Asociacionit/Bashkësisë, kur ato kanë të bëjnë me të gjithë anëtarët e Asociacionit/Bashkësisë.
8. Kuvendi shqyrton, rishikon dhe përcakton prioritetet e politikave për zbatimin e objektivave të Asociacionit/Bashkësisë.
9. Shqyrton dhe miraton marrëveshjet e bashkëpunimit me autoritetet qendrore ose palët e treta, vendase ose të huaja, që kanë të bëjnë me objektivat ose me Asociacionin/Bashkësinë në tërësi.
10. Shqyrton dhe miraton projekte ndërtimore, infrastrukture dhe projekte të tjera investuese me vlerë më të madhe se 50,000 euro, me propozim të Kryetarit dhe Bordit të Asociacionit/Bashkësisë.
11. Shqyrton dhe miraton rregullore dhe vendime të tjera administrative në lidhje me objektivat e Asociacionit/Bashkësisë në përputhje me Statutin dhe Sistemin juridik të Kosovës.
12. Të gjitha vendimet e Kuvendit në përputhje me pikat e përshkruara më sipër janë të zbatueshme për anëtarët e saj. Kur është e nevojshme dhe e përcak-

tuar me Kushtetutë dhe me ligje të Kosovës, komunat pjesëmarrëse do të zbatojnë vendimet e Kuvendit përmes procedurave ligjore, administrative, buxhetore dhe procedurave të tjera që kanë të bëjnë me fushëveprimin e kompetencave të komunave në Kosovë. Çdo anëtar i Asociacionit/Bashkësisë ka të drejtë të shprehë formalisht një vendim ndryshe ose të mos e miratojë një vendim të Kuvendit përmes procedurave të veta të parashikuara me kushtetutë dhe ligj.

13. Si organ më i lartë i Asociacionit/Bashkësisë, Kuvendi mund të vendosë të ndryshojë kompetencat e cilitdo organ tjetër të Asociacionit/Bashkësisë, nëse është e nevojshme përmes ndryshimeve të Statutit.

Neni 10

Kryetari dhe Nënkryetari i Asociacionit/Bashkësisë

1. Asociacioni/Bashkësia do të ketë një Kryetar të zgjedhur nga Kuvendi nga radhët e anëtarëve të kuvendeve të komunave pjesëmarrëse dhe kryetarëve të tyre. Procedura për zgjedhjen e Kryetarit do të rregullohet me Rregulloren e punës së Kuvendit.
